

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

SCC -08-0302

[REDACTED]

Paditëse

Rruga [REDACTED], Prishtinë
e përfaqësuar nga [REDACTED] (Rr. [REDACTED], Prishtinë)

kundër

1. [REDACTED] (e përfaqësuar nga AKM, e cila përfaqësohet nga UNMIK-u) *Të Paditurat*
Ndërmarrje Shoqërore, Prishtinë
2. Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Ilir Konushrvci nr. 8, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme), në përbërje prej Antoinette LEPERTIER-DUREL – Gjyqtare Kryesuese, Esma ERTEZI dhe Gyltene SYLEJMANI, Gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 1 korrik 2010 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Padia e Paditëses [REDACTED] refuzohet si e pabazuar.
2. Shpenzimet gjyqësore në shumë prej 500 € i vihen në barrë paditëses.
3. Kundërpadia e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me shpenzimet procedurale refuzohet.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 16 dhjetor 2008, Paditësja ka ushtruar padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar kompensimin e të ardhurave personale për periudhën në mes të 16 tetorit 1990 dhe 31 dhjetorit 2008. Paditësja nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Paditësja pohoi se ka qenë e punësuar nga NSH [REDAKTUAR] se kontrata iu ka ndërprerë me 16 tetor 1990 dhe se Gjykata e Punës së Bashkuar në Prishtinë, me vendimin e saj MP. Nr. 2997/90 të lëshuar me 19 qershor 1991ka vendosur se ndërprerja e punësimit ka qenë e paligjshme.

Siç thuhet nga Paditësja, Gjykata e Punës së Bashkuar në Prishtinë ka pushuar së funksionuari dhe se shumica e dosjeve të lëndëve janë shkatërruar, përfshirë edhe të sajën. Paditësja po ashtu pohoi se edhe dokumentacioni i saj personal ishte shkatërruar gjatë luftës, por një punonjës i UNMIK-ut e ka lejuar atë që t'i kontrollojë lokalet e NSH [REDAKTUAR] ku ka arritur ti gjejë disa nga dokumentet e saj personale duke përfshirë edhe vendimin e lart-përmendur.

Në padinë e saj, Paditësja ka cekur se në kohën kur është lëshuar vendimi asnjëra nga palët nuk janë ankuar, pastaj ai u bë i plotfuqishëm. Ajo thotë se paga e saj mujore ka qenë rreth 200 Euro; andaj edhe i ka kërkuar 37,945.56 Euro si kompensim dhe 13,250.26 Euro si kamatë, për periudhën prej 16 tetor 1990 deri me 31 dhjetor 2008.

Me 1 prill 2009, në pajtim me nenin 28.4 të Urdhresës Administrative (UA) 2008/6, Gjyqtarja e çështjes ka lëshuar një urdhër duke e udhëzuar paditësen që brenda periudhës prej dy jave nga pranimi i urdhrit t'ia sigurojë Dhomës së Posaçme informacionin me shkrim lidhur me këto pyetje:

a.) Në pajtim me paragrafin (e) të Nenit 27.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, bazën ligjore të padisë dhe faktet materiale lidhur me padinë, e veçmas por pa u kufizuar në:

- Kopjen e librezës së punës apo ndonjë dokument relevant me të cilin dëshmohet punësimi.
- Detajet e provave të cilat Paditësja ka ndërmend ti sjell gjatë seancës dëgjimore për t'i dëshmuar pretendimet e saj, e veçmas por duke mos u kufizuar në paligjshmërinë e ndërprerjes së kontratës së punës.
- Shpjegimin se pse Paditësja kishte pritur 19 vjet për të paraqitur padi kompensimi.

b.) Në pajtim me 25.7 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 përkthimin në Anglisht e të gjitha parashtrësive dhe dokumentacionit përcjellës, e veçanërisht por pa u kufizuar në aktgjykimet bashkangjitur me padi.

Me 22 prill 2009 Paditësja iu ka përgjigjur urdhrit dhe i ka dërguar këto dokumente:

- Librezën e punës,
- Vërtetimin mbi punësimin (të datës 6 qershor 1988),
- Vendimin e NSH [REDAKTUAR] (të datës 22 maj 1990, të pa përkthyer në Anglisht),
- Një parashtrësë nga Paditësja drejtuar Gjykatës Komunale të Prishtinës duke e quajtur Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) si trashëgimtare të NSH-së Metamb në lëndën C. nr. 543/07 (të datës 15 tetor 2008),
- Vendimin MP. nr. 2997/90 (të datës 19 qershor 1991) të Gjykatës së Punës së Bashkuar në Prishtinë,
- Listën e rrogave të NSH –së [REDAKTUAR] (Gusht 1990) përfshirë edhe paditësen.
- Ekspertizën financiare të [REDAKTUAR] (të datës 30 qershor 2008), ku llogariten të ardhurat e humbura.
- Një shkresë (të datës 19 shkurt 1992) drejtuar NSH-së [REDAKTUAR] nga Avokati [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] ku kërkohet ripunësimi i punëtorëve duke përfshirë edhe paditësen.
- Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C1 nr. 453/2007 (të datës 11 dhjetor 2008) ku gjykata shpallet si jo-kompetente duke e udhëzuar paditësen që të paraqes padi në Dhomën e Posaçme.
- Dy kërkesa të paditëses drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë për ta rihapur lëndën M. P. nr. 2995/90 dhe M. P. nr. 2997/90,
- Një vërtetim të Gjykatës Komunale të Prishtinës ku vërtetohet se shkresat e lëndës M .P. 2997/90 nuk mund të gjenden, dhe
- Njoftimin dhënë Agjencisë të datës 21 janar 2008.

Me padi, Paditësja ia kishte siguruar Dhomës së Posaçme edhe dokumentin:

- Vendimin C-534/07 MP. 2997 të datës 27 dhjetor 2007 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë.

Me 2 qershor 2009, Dhoma e Posaçme ia ka dërguar padinë të Paditurës (NSH [REDAKTUAR]) e cila është kthyer si “e panjohur”, më pas padia i është dërguar AKM-së (e përfaqësuar nga UNMIK-u).

Me 20 korrik 2009, AKM-ja e ka paraqitur mbrojtjen e saj. AKM-ja ka kërkuar refuzimin epadisë si të paafatshme në bazë të Nenit 379 të Ligjit mbi Obligimet (Gazeta Zyrtare e SFRJ-së 29/78).

Përveç kësaj, AKM-ja ka thënë se Paditësja nuk ka sjellë argumente për arsyetimin e vonesës së saj për paraqitje të padisë në gjykatën kompetente edhe atëherë kur gjykatat në Kosova kanë rifilluar punën normale pas themelimit të UNMIK-ut në vitin 1999. Pastaj, AKM-ja e ka vënë në dyshim vërtetësinë e aktgjykimit të dorëzuar dhe po ashtu ka shtuar se paditësja nuk ka dorëzuar asnjë provë se aktgjykimi i lart-përmendur vërtetë është bërë i plotfuqishëm. Së fundi, AKM-ja ka thënë se Paditësja, duke mos ndërmarrë veprimin e duhur ligjor për përmbarrimin e aktgjykimit kur ai ishte bërë i

plotfuqishëm dhe së paku në vitin 1999, ajo nuk ka vepruar në pajtim me obligimin e saj për zvogëlimin e dëmeve që ajo i pandeh.

Me 26 gusht 2009, Dhoma e Posaçme e ka ftuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) në gjykim si e Paditur dhe në të njëjtën kohë ia ka dërguar padinë dhe dokumentacionin përcjellës.

AKP-ja e ka paraqitur mbrojtjen e saj me 1 tetor 2009. Ajo ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ta hedh poshtë padinë si të pabazuar. Ajo konsideron se padia nuk mund të pranohet meqë është edhe një procedurë paralele në zhvillim e sipër lidhur me të njëjtën çështje ligjore dhe se në bazë të Nenit 379 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, padia refuzohet sepse afati i parashkrimit prej 10 viteve tanimë kishte kaluar. AKP-ja ka shtuar se Paditësja nuk ka sjellë asnjë provë të diskriminimit e cila do ta kishte penguar atë që të veprojë më herët. Në përputhje me argumentin e AKM-së, AKP-ja po ashtu ka paraqitur se nuk është vërtetuar se Vendimi i Gjykatës së Punës së Bashkuar në Prishtinë ka qenë i plotfuqishëm. Ajo ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Me 5 tetor 2009 Dhoma e Posaçme ia ka dërguar paditëses mbrojtjet e të paditurave.

Paditësja është përgjigjur me 14 tetor 2009. Ajo ka theksuar se nuk ka bazë ligjore e cila parasheh se me rastin e përsëritjes së procedurës, padia duhet të rifillojë aty ku ka mbetur. Ajo ka pohuar se dëshiron ta vazhdojë procedurën dhe se e ka bërë këtë në gjykatën e rregullt meqë më nuk ka Gjykatë të Punës së Bashkuar të Prishtinës. Ajo ka shtuar se diskriminimi që ajo e pohon është fakt i njohur rreth së cilit nuk ka nevojë të debatohet më. Ajo mohon se padia e saj mund të interpretohet si kërkesë periodike dhe ka thënë se lënda e padisë së saj është shkelje flagrante e ligjit mbi marrëdhëniet e punës. Përndryshe, ajo mbeti pranë deklaratave të saja të mëhershme.

Me 7 dhjetor 2009 Dhoma e Posaçme ua ka dërguar të paditurave përgjigjen e paditëses.

AKP-ja e ka paraqitur kundërpërgjigje më 11 janar 2010. Ajo u përgjigj se paditësja me asnjë provë të vlefshme dhe valide nuk e ka arsyetuar vonesën e saj për të paraqitur padi. Ajo pohon se lënda e procedurës së papërfunduar ka qenë kthimi në punë e jo pagesa e pagave mujore. Ajo i ka përsëritur argumentet e saj të mëhershme lidhur me faktin se procedurat e mëparshme nuk kanë përfunduar dhe ka kërkuar që padia të hedhet poshtë.

AKM-ja e ka paraqitur plotësimin e saj të mbrojtjes me 12 janar 2010. Ajo është shprehur se sipas ligjit mbi punësimin, aktgjykimi për kthim në vendin e punës mund të pasojë me një kërkesë për përmbartimin e atij aktgjykimi në Gjykatën Komunale. Ajo ka thënë se kjo padi për kompensim duhet të konsiderohet si padi e re dhe nuk duhet kuptuar si vazhdim i lëndës së mëhershme për punësim. Ajo pohon se kjo padi për të

ardhurat e humbura, e paraqitur në vitin 2008, është, në pajtim me Nenin 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, e lidhur me kërkesat periodike, e kufizuar për një periudhë prej tri vitesh, duke përfunduar se Paditësja mundet të kërkojë kompensimin e të ardhurave të humbura vetëm nga viti 2005. AKM-ja më tej argumenton se NSH-ja [REDAKTUAR] nuk ka funksionuar që nga viti 1999, dhe se puna e paditëses nuk ka ekzistuar më në NSH dhe ka thënë se nëse përmbushja e kontratës pëson ndryshime thelbësore pa fajin e ndonjërës palë, kontrata konsiderohet si e ndërprerë. Ndryshe nga sa u cek më lart, AKM-ja mbeti pranë parashtimeve të saja të mëhershme.

Pastaj procedura me shkrim u mbyll në pajtim me nenin 32 (a) të UA-së së UNMIK-ut 2008/6.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me 13 prill 2010, Paditësja e ka ndryshuar padinë e saj duke kërkuar kompensimin e pagave të humbura deri në datën kur të bëhet pagesa. Ajo ka përmend se meqë NSH-ja në ndërkohë është privatizuar, kompensimi i saj duhet të paguhet nga asetet e ndërmarrjes së likuiduar. Ajo konsideron se vendimi i Gjykatës së Punës ka qenë i plotfuqishëm dhe se ajo nuk ka mundur ta sigurojë përmbartimin e atij vendimi për shkak të situatës së atëhershme diskriminuese në Kosovë. Ajo shpjegoi se ajo ka vepruar në Gjykatën Komunale në vitin 2007 kur ka arritur ta gjejë vendimin në lokalet e ndërmarrjes të marrë nga UNMIK-u.

AKP-ja dhe AKM-ja kanë mbetur pranë parashtesave të tyre. AKP-ja, pasi që i ka përkujtuar ndryshimet që kanë ndodhur në ndërmarrje gjatë viteve të 90-ta dhe vështirësisë për përcaktimin e ndërmarrjes së saktë e cila është dashur ta përmbartojë vendimin e Gjykatës së Punës, poqë se ai ka qenë i plotfuqishëm, ka shtuar se Agjencia nuk mbanë përgjegjësi për borxhet e ndërmarrjeve që ajo duhet t'i administrojë.

Dhoma e Posaçme, me pajtim të palëve, ka kërkuar nga AKM-ja që brenda 15 ditëve nga seanca dëgjimore, t'ia sigurojë asaj dokumentacionin i cili tregon se NSH-ja nuk ka funksionuar më pas vitit 1999.

Procedura gojore shpallet e mbyllur.

Arsyetimi Ligjor:

1. Cilësimi i padisë:

Me padi, Paditësja kërkon kompensimin e dëmeve të cilat ajo pohon se janë shkaktuar nga humbja e të ardhurave të cilat ajo është dashur t'i realizojë po të kishte pasur mundësi që të kthehej në punë në NSH-në [REDAKTUAR].

Dhoma e Posaçme së pari duhet ta sqaron nëse Paditësja, duke vepruar në këtë mënyrë, ka paraqitur padi të re apo e ka rifilluar procedurën e mëparshme.

Dokumentacioni relevant i paraqitur nga Paditësja për vlerësimin e çështjes është si në vijim:

-Vendimi MP .Nr. 2997/90 i lëshuar me 19 qershor 1991 nga Gjykata e Punës në Prishtinë që, sipas saj ajo e ka gjetur në lokalet e NSH-së [REDAKTUAR] në vitin 2007, atëherë e marrë nga UNMIK-u.

-Vendimi C-534/07 MP. Nr. 2997/90 i marrë nga Gjykata Komunale e Prishtinës me 27 dhjetor 2007.

-Vendimi C1 Nr. 534/07 i lëshuar me 11 dhjetor 2008 nga Gjykata Komunale e Prishtinës.

Dokumenti i parë është një kopje e Aktgjykimit MP. Nr. 2997/90 me të cilin anulohen vendimet Nr. 01-497, 01-521, 01-513, 01-512 dhe 01-482 të lëshuara me 16 tetor 1990 nga NSH-ja [REDAKTUAR] e cila i ka obliguar disa punëtorë, në mesin e tyre edhe [REDAKTUAR], që t'i lëshojnë vendet e punës në ndërmarrje.

Me dokumentin e dytë, Gjykata Komunale në Prishtinë, duka pasur parasysh se dosja e lëndës Nr. 2997/90 kishte humbur gjatë luftës dhe se paditësja ka pasur interes ligjor që të procedohet me lëndën, miratohet kërkesa e paditëses për përsëritje të procedurës me numër të ri të regjistrimit.

Dokumenti i tretë është një vendim përmes të cilit Gjykata Komunale në Prishtinë e ka shpallur veten jo-kompetente për ta gjykuar padinë e paditëses kundër NSH-së [REDAKTUAR], meqë sipas Nenit 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive për paditë kreditore të paraqitura kundër një NSH-je nën administrimin e AKM-së.

Nga këto dokumente shihet se paditësja e ka shpreh vullnetin e saj për ta rifilluar dhe përfunduar procedurën e filluar nën numrin 2997/90. Kërkesa e saj është miratuar nga Gjykata Komunale me vendimin e saj të datës 27 dhjetor 2007.

Numrat e dosjeve tregojnë qartë se ka qenë vetëm një dosje e regjistruar nën numrin 2997/90 dhe e përtërirë me numrin C-534/07. Pastaj, në saje të aktgjykimit për mos-kompetencë të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, Paditësja e ka paraqitur padinë e saj në Dhomën e Posaçme.

Përkundër njërit nga argumentet e ngritura nga AKP-ja, nuk ka ndonjë *litispendence* në mes të dy procedurave paralele.

Mirëpo, në vend të kërkesës për rihapje të padisë fillestare lidhur me anulimin e marrëdhënies së saj të punësimit me NSH-në [REDAKTUAR], Paditësja ka paraqitur në

Gjykatën Komunale të Prishtinës e pastaj edhe në Dhomën e Posaçme padi për kompensimin e pagave të humbura.

Këto dy padi të cilat janë paraqitur njëra pas tjetrës me numra të njëjtë të procedurës (fillestarja dhe e ripërsëritura) nuk mund të gjykohen si të njëjta. Në fillimin e procedurës, Paditësja ka kërkuar anulimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit me NSH-në Metamb dhe kthimin e saj në post, në të njëjtën kohë ajo kërkon nga Gjykata Komunale e tani nga Dhoma e Posaçme kompensimin e të ardhurave të humbura.

Faktet janë të ndryshme. Përderisa me padinë e parë kundërshtohet vendimi i NSH-së [REDAKTUAR] për ndërprerje të marrëdhënies së punës, me këtë të tanishmin objekti është dëmtim i pretenduar i shkaktuar nga mos ekzekutimi i obligimit për kthim të paditëses në vendin e saj të punës.

Çështja ligjore po ashtu është e ndryshme. Padia fillestare e ka shpjer Gjykatën e Punës që të shikon se nëse vendimi i NSH [REDAKTUAR] për ndërprerje të marrëdhënies së punës me paditësen është marrë në pajtim me Ligjin e Punës, ndërsa padia e tanishme ka për qëllim vlerësimin e ekzistencës së deliktit dhe se lidhja midis këtij delikti dhe veprimit apo mosveprimit për të cilën NSH-ja [REDAKTUAR] mund të gjykohet si përgjegjëse.

Dhoma e Posaçme nuk mund të ketë mendim të njëjtë me paditësen e cila pohon se asnjë dispozitë nuk thotë se përtëritja e padisë nuk do të thotë se padia duhet të rifilloj aty ku ka mbetur pezull. Kur kërkesa për përtëritje të procedurës lejohet, kjo domosdo do të thotë se ajo procedurë mund të rifillojë nga faza në të cilën ka qenë.

Sa i përket lëndës konkrete, Dhoma e Posaçme e ka shqyrtuar me kujdes aktgjykimin e Gjykatës së Punës të datës 16 tetor 1990 dhe vlerëson se ai është një kopje e cila nuk paraqet ndonjë indikacion që do të dëshmonte se vendimi ka qenë i plotfuqishëm.

Andaj, përtëritja do ta kishte shpjer paditësen që ta kërkoj përmbarrimin e këtij aktgjykimi, çka do ta shpinte Gjykatën Komunale t'ua dërgon atë palëve.

Por, duke vepruar për kompensimin e dëmit, paditësja ka paraqitur padi krejtësisht të re.

2. Mbi meritat e padisë:

Në bazë të Nenit 154 të Ligjit mbi Kontratat dhe Deliktet, "Kushdo që i shkakton lëndim apo humbje tjetrit është përgjegjës që ta kompensojë atë, përveçse ai dëshmon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij."

Për ta dëshmuar të drejtën e saj në kompensim, paditësja duhet sjellë prova të detyrimit të NSH-së [REDAKTUAR] dhe të shkëljes së këtij detyrimi i cili ka rezultuar në dëm të saj.

Në rastin konkret, detyrimi i pandehur që NSH-ja [REDAKTUAR] është dashur ta kryej, sipas paditëses, është që ajo të kthehet në vendin e saj të punës në ndërmarrje dhe ti paguhet të ardhurat mujore nga data e ndërprerjes së kontratës të punës.

Ajo pohoi se ky detyrim është cekur nga Gjykata e Punës në Prishtinë, në aktgjykimin e saj të lëshuar me 19 qershor 1991, me të cilin anulohen vendimet e NSH [REDAKTUAR] duke e obliguar atë që ta lëshojë punën dhe duke e obliguar NSH-në që të rregullojë kthimin e saj në post.

Dhoma e Posaçme nuk mund t'i bindet këtij arsytimi meqë paditësja nuk mund të sjell prova se ky aktgjykim ka qenë i plotfuqishëm dhe kështu i përmbarueshëm. Siç është përmendur më parë, dokumenti i paraqitur është një kopje e aktgjykimit i cili nuk përmban asnjë paragraf ku thuhet se vendimi është i plotfuqishëm.

Kjo do të thotë se anulimi i vendimeve të NSH-së [REDAKTUAR] me të cilin përfundon marrëdhënia e punës ende nuk është i përmbarueshëm andaj edhe NSH-ja ende nuk ka detyrim ndaj paditëses lidhur me kontratën e punës.

Si rrjedhojë, provat për shkelje të detyrimit, tani për tani, nuk mund të sigurohen e as provat për përgjegjësinë e NSH-së.

Andaj edhe padia refuzohet.

Dhoma e Posaçme konsideron se në këtë lëndë nuk ka nevojë të shqyrtohen argumentet e ngritura nga palët lidhur me afatet e parashkrimit të padisë, legjitimiteti faktik i NSH-së [REDAKTUAR] që të paditet si e paditur, përgjegjësia e agjencive për veprimet e NSH-së nën administrimin e tyre, vlefshmëria e arsytimeve se pse paditësja e ka paraqitur padinë e saj vetëm në vitin 2007, përgjegjësinë e vet për mos arritjen e pretendimit për zvogëlim të dëmit dhe ekzistencën e ndonjë dëmi eventual pas vitit 1999. Këto argumente duhet shqyrtuar vetëm atëherë kur të sigurohet dëshmia për shkelje të detyrimit.

3. *Shpenzimet e procedurës dhe taksat gjyqësore:*

Në pajtim me Nenin 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe Nenit 56.2 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2008/6 shpenzimet e procedurës mbulohen nga pala e cila e humbë rastin, këtu, paditësja për faktin se padia e paditëses refuzohet.

AKM-ja nuk e ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. NSH-ja [REDAKTUAR] nuk ka paraqitur mbrojtje. AKP-ja ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të saja por nuk ka paraqitur deklaratë apo faturë lidhur me shpenzimet dhe nuk ka dhënë hollësi lidhur

me shumën e atyre shpenzimeve. Kështu Dhoma e Posaçme nuk mund t'i vlerësojë ato. Kjo kundërpadi duhet të refuzohet.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/02 lidhur me Rregullat Procedurale Shtesë sa i përket taksave gjyqësore të vendosura nga Kryetari i Dhomës së Posaçme, taksat e Dhomës janë mbi këto baza:

- Për paditë që e kalojnë shumën prej 10 000 Euro: tasa prej 50 Euro + 0,5 % të maksimumit prej 500 Euro.

Në këtë lëndë, vlera e padisë siç përcaktohet nga paditësja është 51,195,82 Euro. Andaj, shuma e taksës gjyqësore është 520 Euro.

4. Ankesat:

Në kuptim të Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i këtij vendimi..

Andaj vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Antoinette Lepeltier-Durel,
Gjyqtare Kryesuese, EULEX

(nënshkrimi)

Esmë Ertezi,
Gjyqtare, EULEX

(nënshkrimi)

Gyltene Sylejmani,
Gjyqtare

(nënshkrimi)

Tobias Lapke,
Regjistruar, EULEX

(nënshkrimi)

